

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

STUDIMET MASTER - DREJTIMI FINANCIAR



PUNIM DIPLOME-MASTER

TEMA:

**IMPAKTI I MJEDISIT LIGJOR DHE KORNIZËS RREGULLATORE NË
QEVERISJEN E KORPORATAVE NË EKONOMITË NË TRANZICION**

Mentori:

Prof.Ass.Dr. Artor Nuhii

Kandidatja:

Leona Sfishta

Prishtinë, 2025

ABSTRAKT

Ky punim synon të analizojë ndikimin e mjedisit ligjor dhe rregullator në qeverisjen e korporatave në vendet që kalojnë nga ekonomitë e planifikuara qendrore drejt ekonomive të tregut të lirë, me fokus të veçantë në Ballkanin Perëndimor dhe Evropën Lindore.

Ekonomitë në tranzicion përballen me sfida të mëdha strukturore gjatë këtij transformimi, ku krijimi dhe forcimi i institucioneve ligjore dhe rregullatore janë thelbësore për të mundësuar një treg konkurrues dhe transparent. Mjedisi ligjor dhe rregullator luan një rol vendimtar në formësimin e sjelljes së korporatave dhe në krijimin e kushteve për investime dhe zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Punimi shqyrton ndikimin e ligjeve mbi pronësinë, kontratat, konkurrencën dhe mbrojtjen e aksionarëve në qeverisjen e korporatave, duke krahasuar raste studimore nga Kosova, Shqipëria, Polonia dhe Çekia.

Analiza nxjerr në pah se Polonia dhe Çekia kanë zhvilluar sisteme ligjore dhe rregullatore më të qëndrueshme, duke mbështetur një qeverisje më efektive të korporatave, ndërsa Kosova dhe Shqipëria përballen me pengesa të mëdha për shkak të mungesës së stabilitetit ligjor, zbatimit të dobët të ligjeve dhe transparencës së pamjaftueshme. Përmes të dhënave nga anketa dhe studime të ndryshme, identifikohen sfidat kryesore si korrupsioni i institucioneve rregullatore, mungesa e kapaciteteve dhe zbatimi joefektiv i kuadrit ligjor.

Punimi ofron rekomandime për përmirësimin e mjedisit ligjor dhe rregullator, duke përfshirë nevojën për reforma ligjore, forcimin e institucioneve rregullatore dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në sektorin privat dhe publik. Ky studim kontribuon në literaturën ekzistuese duke sjellë një analizë të detajuar të ndikimit të mjedisit ligjor në qeverisjen e korporatave në kontekstin e ekonomive në tranzicion dhe duke theksuar rëndësinë e reformave të vazhdueshme për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Fjalë kyçe: Qeverisja e korporatave, mjedisi ligjor, korniza rregullatore, ekonomitë në tranzicion, Ballkani Perëndimor, Evropa Lindore, transparenca, reforma ligjore.